



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 471 Prot.

Tiranë, më dt. 24.11.2017

VENDIM

Nr. 356, dt. 24.11.2017

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, dhe në Rregulloren e miratuar me vendim KKR nr. 75, datë 03.04.2015 “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit”, në mbledhjen e dt. 24.11.2017 Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, pasi shqyrtoi kërkesën për licensim në fushën e restaurimit për Ark. Zef Çuni,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën për pajisje me licensë restaurimi profesionale individuale në fushën e restaurimeve për kategorinë AP. “Projektim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës”, me nënkategoritë AP/1, AP/2, AP/3, AP/4 dhe AZ. “Zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës” me nënkategoritë AZ/1, AZ/2, AZ/3, AZ/4, sipas rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit” të Ark. Zef Çuni.
2. T’i propozojë Ministrit të Kulturës, pajisjen e arkeologut Ark. Zef Çuni me licensë restaurimi profesionale individuale në fushën e restaurimeve për kategorinë AP. “Projektim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës”, me nënkategoritë AP/1, AP/2, AP/3 AP/4 dhe AZ. “Zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës” me nënkategoritë AZ/1, AZ/2, AZ/3, AZ/4.
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Mirela Kumbaro Furxhi



SEKRETAR I KKR I DELEGUAR

Arta Dollani